

Vendim nr. 66 datë 06.12.2023
(V-66/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 06.12.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: GJERGJ VLADI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS,
MINISTRIA E MBROJTJES

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 4483, datë 25.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15/2, 17, 18, 33/1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 29 e 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e

prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës (*Presidenti*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gjergj Vladi, me urdhrin nr. 1157, datë 25.05.1982 të ministrit të Mbrojtjes, ka marrë titullin “oficer aktiv” duke filluar nga data 16.06.1982. Me dekretin nr. 1738, datë 12.03.1995 të Presidentit ka marrë gradën “gjeneral brigade”. Presidenti, me dekretin nr. 1889, datë 04.09.1997, ka vendosur lirimin nga detyra të kërkuesit, duke e vendosur në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vijim, me dekretin nr. 2144, datë 22.06.1998 të Presidentit (*dekreti nr. 2144/1998*), kërkuesi është ulur në gradë për shkelje të rëndë të disiplinës ushtarake. Me urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr. 2367/1, datë 24.07.1998 kërkuesi ka dalë në rezervë në pamundësi sistemimi në detyrë tjetër në përshtatje me gradën ushtarake të tij. Të drejtat financiare si oficer aktiv i janë ndërprerë në datën 21.06.1998, dhe pas kësaj date është trajtuar sipas nenit 10 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror, suplementar, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, me të ardhura mujore bruto 29.680 lekë në muaj.

2. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt anulimin e dekretit për uljen në gradë. Me vendimin nr. 3142, datë 01.06.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur anulimin pjesërisht të dekretit nr. 2144/1998, në pikën 1, paragrafi 3, të tij, që bën fjalë për kërkuesin. Me vendimin nr. 1436, datë 15.11.2006, kjo gjykatë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 3142, datë 01.06.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas ekzekutimit të vendimit, kërkuesi është nxjerrë në rezervë me dekretin nr. 5261, datë 13.04.2007 të Presidentit.

3. Nga data 13.05.2007 kërkuesi është trajtuar me pagesë kalimtare sipas nenit 12 të ligjit nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” në masën 50% të pagës referuese mujore 32.350 lekë në muaj.

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, për të paguar shumën që përbëhet nga shpërblimi i pagës, shpërblimi për vjetërsi, shpërblimi për shkak të gradës, si dhe

shpërblimi i pagës së bashkëshortes për periudhën e heqjes së gradës nga data 22.06.1998 deri në datën 11.05.2007. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4483, datë 25.05.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

5. Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1063, datë 09.06.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4483, datë 25.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; detyrimin e Ministrisë së Mbrojtjes për t'i paguar kërkuarit shpërblimin e pagës për periudhën e heqjes së gradës nga data 22.06.1998 deri në datën 11.05.2007 dhe sigurimet shoqërore; rrëzimin e kërkesës për pjesët e tjera. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2211 (258), datë 03.04.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1063, datë 09.06.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4483, datë 25.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Në datën 05.04.2016 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe standardin e arsytimit të vendimit. Gjykata, pasi vlerësoi se këto pretendime ishin të bazuara, me vendimin nr. 82, datë 20.09.2016 (*vendimi nr. 82/2016*), ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2211 (258), datë 03.04.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka rishqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022, ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr. 1063, datë 09.06.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 4483, datë 25.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*".

9. Në datën 20.04.2023 kërkuari i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 21.06.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt, në drejtim të:

- 10.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë marrë parasysh dispozitivin e vendimit me të cilin është vendosur anulimi pjesërisht i dekretit të Presidentit për uljen e gradës madhore, duke anashkaluar pasojat ligjore që sjell ky vendim. Anulimi i dekretit të Presidentit ka bërë të pavlefshëm edhe urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për nxjerrjen në rezervë të kërkuesit, për rrjedhojë data e nxjerrjes në rezervë duhet të konsiderohet data 13.04.2007 që i përket dekretit të dytë të Presidentit. Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë e konsiderojnë urdhrin e ministrit të Mbrojtjes të datës 24.07.1998 për daljen në rezervë si akt të pashfuqizuar, gjë e cila nuk është e vërtetë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar me dy standarde dhe nuk ka respektuar praktikën gjyqësore për raste të ngjashme gjykimi, duke dhënë vendime të kundërta.
- 10.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga gjykata e apelit për sa i përket vlerësimit të vendimit të formës së prerë dhe akteve të tjera administrative të paraqitura si provë në gjykim. Kolegji Administrativ duhej t'i kishte prishur vendimet gjyqësore dhe ta kthente çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, referuar nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi nuk është detyrë e tij të gjykojë çështjen në fakt.
- 10.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është jokohorent dhe ka përplasje të argumenteve. Megjithatë në vendim pranohet se është anuluar dekreti i Presidentit që ka ulur në gradë kërkuesin, më tej në vendim konsiderohet se ai ka qenë në rezervë, por nuk arsyetohet se pse është nxjerrë një dekret i ri për daljen në rezervë të kërkuesit. Vlerësimi i kësaj gjykate se kërkuesi nuk ka qenë ushtarak aktiv dhe nuk ka kryer asnjë detyrë në Forcat e Armatosura është i njëanshëm, i pasaktë dhe jo i vërtetë. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se cilin ligj nuk ka respektuar gjykata e apelit, duke mos dhënë asnjë referencë ligjore për të mbështetur interpretimin e saj.
- 10.4. *Standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar vendimin e Gjykatës nr. 82/2016, duke mos mbajtur një qëndrim të njësuar, por e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë ajo ka cenuar edhe parimin e shtetit të së

drejtës dhe hierarkisë së akteve. Megjithëse Gjykata e Lartë ka pranuar se ka praktika të kundërta, ajo është shprehur se ato nuk janë të një sasive që të justifikojë unifikimin e praktikës. Ky refuzim i Gjykatës së Lartë nënkupton se ajo vepron me dy standarde, për çështjet e vjetra dhe ato të reja. Në këtë mënyrë kjo gjykatë ka cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës. Vlerësimi i kësaj gjykate se për kërkuesin nuk është vendosur kthimi si ushtarak aktiv është vetëm konstatues dhe i paargumentuar.

- 10.5. Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar nenin 20 të ligjit nr. 9210/2004, pasi në kushtet e anulimit të dekretit të Presidentit për uljen në gradë, kërkuesi ka qenë ushtarak aktiv. Masa disiplinore e uljes së gradës ishte e përkohshme dhe shuhej brenda 6 muajve, për rrjedhojë pas kalimit të këtij afati kërkuesi gëzonte sërish gradën “gjeneral brigade”. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes për daljen në rezervë ishte i paligjshëm, pasi nisur nga fakti se kërkuesi gëzonte gradën “gjeneral brigade”, sipas ligjit kompetenca për daljen në rezervë i takon Presidentit. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë një vlerësim në kundërshtim me nenin 7 e vijues të KPC-së, duke mos kryer një vlerësim ligjor të fakteve dhe provave të administruara në gjykim.

11. Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

- 11.1. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga ana e Gjykatës së Lartë, si dhe analizën e fakteve ku janë bazuar gjykatat e zakonshme për zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes, për rrjedhojë nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.
- 11.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi gjykatat më të ulëta dhe Gjykata e Lartë nuk kanë marrë në shqyrtim çështjen që ka trajtuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka anuluar dekretin për uljen e gradës madhore “gjeneral brigade”. Ky vendim nuk ka shfuqizuar urdhrin e daljes në rezervë, por vetëm dekretin për uljen në gradë. Megjithëse, nga njëra anë, kërkuesi pretendon se nuk ka kërkuar pagën si ushtarak aktiv, nga ana tjetër, i referohet vendimit që i ka njohur gradën e hequr dhe sipas atij vendimi duhet të përfitojë pagën si ushtarak aktiv. Vendimet të cilat referon kërkuesi kanë pasur palë të ndryshme, objekte të ndryshme gjykimi, nuk kundërshtojnë njëri-tjetrin, pra nuk krijojnë situata të ndryshme juridike, duke mos e vendosur atë në një situatë të

pasigurt juridike. Kërkuesi nuk mund të pretendojë që për shkak të vendimit të parë gjyqësor, vendimi i dytë të konsiderohet vetëm formal.

11.3. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument konkret. Vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka bërë interpretim të ligjit ndryshe nga gjykata e apelit, nuk përbën cenim të këtij parimi. Ky pretendim lidhet me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë ligji, si dhe nuk rezulton që ajo të ketë marrë ose administruar prova të reja.

11.4. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit*, pasi argumentet e kërkuesit në këtë drejtim janë të përgjithshme dhe mbështeten vetëm në faktin se Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar drejt vendimin gjyqësor me të cilin i është kthyer grada “gjenral brigade”. Vendimi i kësaj gjykate është i rregullt në formë dhe përmbajtje dhe ka trajtuar të gjitha çështjet e ngritura duke dhënë argumentet përkatëse, si dhe ka shprehur qëndrimin edhe mbi detyrat e lëna nga Gjykata. Nga rrethanat rezulton se kërkuesi nuk ka qenë ushtarak aktiv dhe nuk ka kryer detyra konkrete ose shërbime. Edhe kërkesëpadia drejtuar gjykatave të zakonshme nuk përmban asnjë dispozitë ligjore e cila të parashikojë pagimin e pagës ose kërtimeve të tjera. Për më tepër, kërkesa e tij për trajtimin me pagë është parashkruar me kalimin e afatit ligjor 3-vjeçar, pasi shkëputja e marrëdhënieve të punës ka qenë në vitin 1998.

12. **Subjekti i interesuar, Presidenti**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit

nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar procesin e përmbyllur me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili është marrë pas rikthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata me vendimin nr. 82/2016. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.12.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 20.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, një kusht tjetër paraprak për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual lidhet me përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*). Sipas këtyre dispozitave, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuenin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit, janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t’i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes, ka prapësuar se kërkuksi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit e interpretimit të ligjit nga ana e Gjykatës së Lartë dhe analizën e fakteve ku janë bazuar gjykatat e zakonshme për zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

19. Gjykata vëren se kërkuksi ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe standardit të arsytimit, pretendime të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës. Prandaj, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i interesuar, Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohet edhe *ratione materiae* për këto pretendime.

20. Përveç këtyre pretendimeve, kërkuksi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar nenin 20 të ligjit nr. 9210/2004, pasi në kushtet e anulimit të dekretit të Presidentit për uljen në gradë, kërkuksi ka qenë ushtarak aktiv. Masa disiplinore e uljes së gradës ishte masë e përkohshme, e cila shuhej brenda 6 muajve, për rrjedhojë pas kalimit të këtij afati, kërkuksi gëzonte sërish gradën “gjeneral brigade”. Urdhri i ministrit të Mbrojtjes për daljen në rezervë ishte i paligjshëm, pasi nisur nga fakti se kërkuksi gëzonte gradën “gjeneral brigade”, sipas ligjit kompetenca për daljen në rezervë i takon Presidentit. Po sipas tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë një vlerësim në kundërshtim me nenin 7 e vijues të KPC-së, duke mos kryer një vlerësim ligjor të fakteve dhe provave të administruara në gjykim. Në vlerësimin e Gjykatës ky pretendim ka të bëjë me interpretimin e ligjit, i cili i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues, prandaj kërkuksi nuk legjitimohet *ratione materiae* në këtë drejtim.

21. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuksit, Gjykata vëren se, në thelb, ato janë të njëjta me ato të parashtruara në ankimin kushtetues individual të shqyrtuar me vendimin nr. 82/2016 të Gjykatës (*shih paragrafin 7 më sipër*). Në këto kushte, duke qenë se çështja është shqyrtuar përsëri nga Gjykata e Lartë, pretendimet e tij do të trajtohen në drejtim të respektimit nga Gjykata e Lartë të standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsytimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është jokohorent dhe ka përplasje të argumenteve. Megjithëse në vendim pranohet se është anuluar dekreti i Presidentit që ka ulur në gradë kërkuesin, më tej konsiderohet se ai ka qenë në rezervë, por nuk arsyetohet se pse është nxjerrë një dekret i ri për daljen në rezervë të tij. Vlerësimi i kësaj gjykate se kërkuesi nuk ka qenë ushtarak aktiv dhe nuk ka kryer asnjë detyrë në Forcat e Armatosura është i njëanshëm, i pasaktë dhe jo i vërtetë. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se cilin ligj nuk ka respektuar gjykata e apelit, duke mos dhënë asnjë referencë ligjore për të mbështetur interpretimin e saj. Gjithashtu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar vendimin e Gjykatës nr. 82/2016, duke mos mbajtur një qëndrim të njësuar, por e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë, ai ka cenuar edhe parimin e shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së akteve. Megjithëse Gjykata e Lartë ka pranuar se ka praktika të kundërta, ajo është shprehur se ato nuk janë të një sasive që të justifikojë unifikimin e praktikës. Ky refuzim i Gjykatës së Lartë nënkupton se ajo vepron me dy standarde, për çështjet e vjetra dhe ato të reja, duke cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës. Vlerësimi i kësaj gjykate se për kërkuesin nuk është vendosur kthimi si ushtarak aktiv është vetëm konstatues dhe i paargumentuar.

23. Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi argumentet e kërkuesit në këtë drejtim janë të përgjithshme dhe mbështeten vetëm në faktin se Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar drejt vendimin gjyqësor me të cilin i është kthyer grada “gjenral brigade”. Vendimi objekt kundërshtimi është i rregullt në formë dhe përmbajtje dhe ka trajtuar të gjitha çështjet e ngritura duke dhënë argumentet përkatëse, si dhe ka shprehur qëndrimin e saj edhe për detyrat e lëna nga Gjykata. Nga rrethanat rezulton se kërkuesi nuk ka qenë ushtarak aktiv dhe nuk ka kryer detyra konkrete apo në shërbim. Edhe kërkesëpadia drejtuar gjykatave të zakonshme nuk përmban asnjë dispozitë ligjore e cila të parashikojë pagimin e pagës apo kërtimeve të tjera. Për më tepër, kërkesa e tij për trajtimin me pagë është parashkruar me kalimin e afatit ligjor 3-vjeçar, pasi shkëputja e marrëdhënieve të punës ka qenë në vitin 1998.

24. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek

argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithashtu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 13 datë 21.03.2023; vendimet nr. 11, datë 24.05.2022; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të kërkuarit si në kërkesën e parë drejtuar Gjykatës, ashtu edhe në kërkesën objekt shqyrtimi ka të bëjë me faktin se Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk kanë marrë parasysh dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 3142, datë 01.06.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur anulimi pjesërisht i dekretit të Presidentit për uljen e gradës madhore, duke anashkaluar pasojat ligjore që sjell ky vendim si dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar me dy standarde dhe nuk ka respektuar praktikën gjyqësore për raste të ngjashme gjykimi, duke dhënë vendime të kundërta.

27. Në vendimin e saj të mëparshëm nr. 82/2016, Gjykata ka arritur në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi në çështje të tjera, ku pretendimet kanë qenë të njëjta me ato të kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme, për rrjedhojë ka vend për të mbajtur një qëndrim njëses nga Kolegjet e Bashkuara në lidhje me zbatimin e ligjit për pretendimet e parashtruara para saj (*shih paragrafët 19-21 të vendimit nr. 82/2016 të Gjykatës*). Gjithashtu, Gjykata, në vendimin nr. 82/1016, ka vlerësuar të cenuar standardin e arsytimit të vendimit, në kushtet kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar qëndrimin e tij lidhur me efektet e vendimit të formës së prerë nr. 3142, datë 01.06.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky i fundit ka anuluar dekretin që ka ulur në detyrë kërkuarin, gjë e cila passillte detyrimin për të argumentuar pasojat që vinin si rrjedhojë e atij vendimi (*shih paragrafin 28 të vendimit nr. 82/2016 të Gjykatës*).

28. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka rishqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe lidhur me konstatimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike ka vlerësuar se ai u referohet ligjeve të kohës kur është gjykuar për herë të parë kjo çështje, sipas të cilave kryetari i Gjykatës së Lartë, secili nga kolegjet ose Kolegjet e Bashkuara mund të kërkonin që

kjo gjykatë të shprehej në Kolegje të Bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme të mëparshme në kolegje të thjeshta. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ ka arritur në përfundimin se detyra e lënë nga Gjykata për Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka mbetur pa zbatim, si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, të cilat forcuan më tepër rolin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji i zakonshëm e dërgon një çështje për njësim pranë kolegjit me pesë gjyqtarë vetëm kur nëpërmjet zhvillimit të praktikës gjyqësore nuk mund të ndreqet shkelja e rëndësishme e ligjit material e kryer prej gjykatave më të ulëta dhe jo çdo vendimmarrje që nuk është e njëjtë mund të justifikojë automatikisht kalimin për njësim. Në përfundim, Kolegji Administrativ ka argumentuar se ka mundësi ta ndreqë vetë praktikën gjyqësore sporadike (që nuk përputhet me linjën e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Kolegjit), duke konsoliduar një qëndrim të mbajtur në vijimësi (*shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

29. Nisur nga këto fakte, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se në rastin e kërkuarit, problematika e paraqitur për gjykim, si dhe praktikën e kundërta të gjetura nga Gjykata nuk janë të një sasive, kohe dhe natyre të tillë që të justifikojnë zhvillimin e një procedure njëse. Në këtë rast, kompetenca për zhvillimin e praktikës gjyqësore e plotëson më së miri nevojën për siguri juridike, pasi në referim të nenit 58, shkronja “b”, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*ligji nr. 49/2012*) praktika e zhvilluar nga Kolegji Administrativ është e detyrueshme për gjykatat më të ulëta dhe përbën shkak rekursi për çështje të ngjashme në të ardhmen (që nuk i përmbahen praktikës së zhvilluar sipas kriterëve të sipërcituara). Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk ka vend për njësimin e praktikave të vjetra gjyqësore, për sa kohë që nuk vihen re kontradikta të njëkohshme në praktikën e kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë, por vetëm për zhvillimin e praktikës gjyqësore (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

30. Gjykata vëren se me ndryshimet e reja kushtetuese, neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Për shkak të delegimit që neni 141 ka bërë të ligji, Kuvendi ka miratuar ndryshimet ligjore të nevojshme për zbatimin e kompetencave të reja kushtetuese të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuadër është miratuar edhe ligji nr. 39/2017 (*hyrë në fuqi në datën 21.04.2017*), me të cilin është ndryshuar ligji nr. 49/2012. Referuar nenit 58 të këtij ligji, një nga shkaqet e rekursit është edhe kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika e Kolegjit Administrativ ose e

Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ndërsa sipas pikës 4 të nenit 31 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Administrativ gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë. I njëjti formulim gjendet edhe në nenin 12 të ligjit nr. 49/2012, i cili, përveç sa më lart, parashikon edhe se kolegjet me pesë gjyqtarë shqyrtojnë në seancë gjyqësore çështje për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

31. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës kishte përcaktuar në mënyrë të qartë detyrën se kishte vend për një qëndrim njësoj nga Gjykata e Lartë për shkak të praktikave të ndryshme të njëkohshme. Thënë ndryshe, Gjykata kishte arritur në përfundimin se thelbi që përbënte konfliktin në fjalë kishte marrë zgjidhje të ndryshme nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, bazuar në interpretime të ndryshme mbi të njëjtën bazë ligjore, prandaj praktika gjyqësore e krijuar kishte mjaftueshëm arsye për t’u njësuar prej saj. Kjo do të thotë se njësimi i praktikës ishte detyra e lënë për zbatim nga Gjykata, ndërsa përcaktimi i organit (Kolegjet e Bashkuara sipas ligjit të kohës) ishte në funksion të kësaj detyre. Ndërkohë, referuar ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, kompetenca e njësimit aktualisht i përket trupës gjyqësore me 5 gjyqtarë, duke mos qenë më kompetencë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

32. Pavarësisht këtyre përcaktimeve, Kolegji Administrativ në rishqyrtimin e çështjes vendosi të vlerësojë përsëri nëse praktikët e kundërta, tashmë të konstatuara nga Gjykata, linin vend për njësimin apo për zhvillimin e tyre. Duke vënë në diskutim vendimin e Gjykatës, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se nuk ka vend për njësim të praktikës, por vetëm për zhvillimin e saj dhe e ka shqyrtuar çështjen me një trupë me tre gjyqtarë.

33. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vlerëson se për t’i dhënë zgjidhje situatës së kërkuesit, Kolegji Administrativ, edhe pse nuk mund ta kalonte çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, të cilat nuk kanë më kompetencën për njësimin e praktikës gjyqësore, ishte i detyruar të zbatonte vendimin e Gjykatës në lidhje me detyrën thelbësore të lënë prej saj, njësimin e praktikës gjyqësore. Kjo çështje nuk mund të vihej më në diskutim nga Kolegji Administrativ, i cili për të zbatuar detyrën e lënë duhet t’ia kalonte çështjen për shqyrtim organit që sipas parashikimeve të reja ligjore ka tashmë këtë kompetencë, pra trupës me 5 gjyqtarë.

34. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrat e përcaktuara nga vendimi nr. 82/2016, për sa kohë Kolegji Administrativ i kësaj

gjykate ka vlerësuar çështjen e kërkuarit vetëm në drejtim të zhvillimit të praktikës, pra të zbatimit dhe interpretimit të ligjit, duke e trajtuar si një rekurs të paraqitur për herë të parë dhe duke e shndërruar detyrën e lënë nga Gjykata në një çështje juridike në vlerësimin diskrecional të tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ, me vendimin e kundërshtuar, ka cenuar besueshmërinë e kërkuarit të sistemi juridik, shteti, institucionet dhe aktet që ato nxjerrin. Ky i fundit, pas vendimit të dhënë nga Gjykata, kishte pritshmëri të ligjshme që zbatimi i ligjit që zgjidhte çështjen e tij do të njësohej sipas detyrave të lëna prej saj.

35. Nga sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsytimit të vendimit, është i bazuar. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.12.2023

Shpallur më 08.01.2024

MENDIM PAKICE

1. Për çështjen me kërkuar Gjergj Vladi, me objekt “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 4483, datë 25.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi

vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Për këtë arsye çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuuesi, në përfundim të një procesi gjyqësor në cilësinë e palës paditëse dhe me objekt pagimin e shpërblimit të pagës, në datën 05.04.2016 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), e cila me vendimin nr. 82, datë 20.09.2016 ka shfuqizuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën, vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që kishte vendosur mospranimin e rekursit të tij, duke dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë. Gjykata ka konstatuar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi në çështje të tjera, ku pretendimet kanë qenë të njëjta me ato të kërkuessit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme dhe për rrjedhojë kishte vend për të mbajtur një qëndrim njësoj nga Kolegjet e Bashkuara në lidhje me zbatimin e ligjit për pretendimet e parashtruara para saj. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar të cenuar standardin e arsytimit të vendimit, në kushtet kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar qëndrimin e tij lidhur me efektet e vendimit gjyqësor, i cili kishte anuluar dekretin që ka ulur në detyrë kërkuessin, gjë e cila passillte detyrimin për të argumentuar pasojat që vinin si rrjedhojë e atij vendimi.

3. Pas rishqyrtimit të çështjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur përsëri mospranimin e rekursit të kërkuessit. Në këto kushte, ai i është drejtuar Gjykatës duke kundërshtuar këtë vendim, me pretendimin se ai ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit të lidhur me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës.

4. Shumica, në analizë të vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ, ka vendosur pranimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se ky kolegji edhe pse nuk mund ta kalonte çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, kishte për detyrë të zbatonte vendimin e Gjykatës në lidhje me detyrën thelbësore të lënë prej saj, njësimin e praktikës gjyqësore. Kjo çështje nuk mund të vihej më në diskutim nga Kolegji Administrativ, i cili për të zbatuar detyrën e lënë duhej t'ia kalonte çështjen për shqyrtim organit që sipas parashikimeve të reja ligjore ka tashmë këtë kompetencë, pra trupës me 5 gjyqtarë. Për rrjedhojë, shumica ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara nga vendimi nr. 82/2016, për sa kohë Kolegji Administrativ i kësaj gjykate ka vlerësuar çështjen e kërkuessit vetëm në drejtim të zhvillimit të praktikës, pra të zbatimit dhe interpretimit të ligjit, duke e trajtuar si një rekurs të paraqitur për herë të parë. Duke vepruar në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ me vendimin e kundërshtuar ka cenuar besueshmërinë e kërkuessit te sistemi juridik, shteti, institucionet dhe aktet që ato nxjerrin, pasi kërkuessit pas vendimit të dhënë nga Gjykata kishte pritshmëri të

ligjshme që zbatimi i ligjit që zgjidhte çështjen e tij do të njësohej sipas detyrave të lëna prej saj (*shih paragrafët 33-34 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga sa shumica ka konkluduar, vlerësojmë se vendimi objekt kundërshtimi ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 82/2016 i Gjykatës dhe se pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë të pabazuara. Në radhë të parë sjellim në vëmendje se vendimmarrja e Gjykatës i përket periudhës para ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese të vitit 2016, të cilat ndryshuan rolin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, duke fuqizuar kompetencat e tyre në drejtim të sigurimit dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore. Një gjë e tillë pranohet edhe nga vetë Gjykata e Lartë, e cila shprehet se Kolegjet e Bashkuara nuk kanë më rol parësor në njësimin e praktikës gjyqësore dhe kolegji i zakonshëm e dërgon një çështje për njësim pranë kolegjit me pesë gjyqtarë vetëm kur nëpërmjet zhvillimit të praktikës gjyqësore nuk mund të ndreqet shkelja e rëndësishme e ligjit material e kryer nga gjykatat më të ulëta. Me ndryshimet ligjore kolegjet mund ta ndreqin vet praktikën gjyqësore dhe duke vlerësuar se çështja e kërkuarit nuk ishte e një sasive, kohe dhe natyre të tillë që të justifikonte gjykimin nësues, Kolegji Administrativ e ka gjetur të plotësuar nevojën për sigurinë juridike nëpërmjet ushtrimit të kompetencës për zhvillimin e praktikës (*shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

6. Po kështu, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se nuk vihen re kontradikta të njëkohshme në praktikën e kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë nuk ka vend për njësimin e praktikave të vjetra, ku bën pjesë edhe rasti i kërkuarit. Në zbatim të detyrave të përcaktuara në vendimin nr. 82/2016 të Gjykatës, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se ka vend për saktësimin dhe arsyetimin e zbatimit korrekt të ligjit për çështjen e kërkuarit, duke iu referuar shkaqeve të rekursit që parashikonte ligji i kohës kur është paraqitur ai (*shih paragrafin 18 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

7. Në analizë të sa më lart, vlerësojmë se megjithëse Gjykata e Lartë është shprehur se detyra e lënë nga Gjykata për Kolegjet e Bashkuara ka mbetur pa zbatim dhe nuk ka vend për njësimin e praktikës gjyqësore, ajo ka vepruar brenda funksioneve të saj kushtetuese të përcaktuara nga neni 141 i Kushtetutës. Kështu, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit ajo ka kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, duke konkluduar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, në zbatim të detyrës tjetër të Gjykatës për arsyetimin e efekteve të vendimit gjyqësor i cili kishte anuluar dekretin që ka ulur në detyrë kërkuarin, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar drejt lidhur me faktin se anulimi i dekretit të Presidentit për uljen

në gradë të kërkuesit nuk ka shfuqizuar edhe urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për daljen në rezervë të tij, pra nuk është vendosur për kthimin e paditësit si ushtarak aktiv (*shih paragrafin 23 të vendimi të Gjykatës së Lartë*). Në këtë mënyrë, vlerësojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë ka përmbushur mjaftueshmërisht edhe standardin e arsytimit të vendimit. Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit, duke plotësuar kështu kërkesat për respektimin e këtij standardi.

8. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se jurisprudenca nuk mbetet e pandryshueshme, por përkundrazi ajo evoluon në thelb, dhe parimi i administrimit të mirë të drejtësisë nuk nënkupton imponimin e konsistencës strikte të praktikës gjyqësore (*shih vendimin e GJEDNJ-së Unédic kundër Francës, aplikimi nr. 20153/04, datë 18.12.2008, § 73*). Ajo, gjithashtu, ka arsyetuar se dy gjykata të ndryshme mund të arrijnë në përfundime të ndryshme, por racionale dhe të arsyetuara në lidhje me të njëjtën çështje juridike të ngritur nga rrethana të ngjashme faktike. Duhet pranuar se divergjencat që mund të lindin në këtë mënyrë ndërmjet gjykatave janë thjesht rezultat i pashmangshëm i këtij procesi të interpretimit të dispozitave ligjore dhe përshtatjes së tyre me situatat materiale që ato synojnë të mbulojnë. Megjithatë, këto divergjenca mund të pranohen kur sistemi i brendshëm ligjor është në gjendje të zgjidhë vetë mosmarrëveshjet, ose duke vendosur me të njëjtën qasje, ose duke respektuar kufijtë përkatëse të juridiksionit (*shih vendimin e GJEDNJ-së Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, aplikimi nr. 13279/05, datë 20.10.2011, §§ 86-87*). Për GJEDNJ-në, kur nuk ka prova për arbitraritet, kontrolli i ekzistencës dhe ndikimit të vendimeve të tilla kontradiktore nuk nënkupton shqyrtimin e qasjes që kanë zgjedhur të përdorin gjykatat (*shih vendimin e GJEDNJ-së Vinčić dhe të tjerë kundër Serbisë, aplikimi nr. 44698/06, datë 01.12.2009, § 56*).

9. Nga sa më lart, vlerësojmë se duke arsyetuar çështjen në këndvështrim të parashikimeve të reja kushtetuese ligjore dhe kompetencave të reformuara të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 82/2016 i Gjykatës. Për rrjedhojë, çmojmë se vendimi objekt kundërshtimi, duke balancuar nevojën për zhvillimin e praktikës gjyqësore me parimin e sigurisë juridike të kërkuesit, nuk konstatohet të ketë sjellë pasoja në cenimin e parimit të shtetit të së drejtës.

10. Në përfundim, për të gjitha argumentet e përmendura më sipër, vlerësojmë se në rastin e kërkuesit Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës.

Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini